



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.134/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Fushë Kosovë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 06.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për Kryetar të Komunës së Fushë-Kosovës, nga radhët e subjektit politik LDK- Burim Berisha, ka shkelur Rregullën Zgjedhore 13/2013, Nenin 5.2, duke përfshirë persona nën moshën 18 vjeçare (të mitur) në fushatën zgjedhore. Këtë pretendim e bazojnë në disa foto të publikuara nga një portal, të një tubimi politik ku shihen fëmijë duke mbajtur të veshur bluza të kandidatit Burim Berisha.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri (3) fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 07.10.2017, ka njoftuar se përkundër faktit që Shtabi Qendror Zgjedhor i LDK-së ka kërkuar që gjatë fushatës të gjitha degët dhe kandidatët t'iu përmbahen dispozitave ligjore, në rastin sikurse në ankesën Anr.134/2017, pa dijen e degës dhe të kandidatit dikush nga familjet që e mbështesin LDK-në në fshatin ku është organizuar takimi i kanë veshur dhe sjellur fëmijët pranë kandidatit për të bërë foto. Prandaj në asnjë rast, kandidati dhe as dega e LDK-së në Fushë-Kosovë nuk mund të mbahen përgjegjës për një veprim të tillë, ndërsa fotoja e kryetarit duhet të kuptohet vetëm si një gjest mirësjelljeje nga ana e tij në raport me këta fëmijë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Burim Berisha, kandidat për Kryetar të Komunës së Fushë-Kosovës, nga radhët e subjektit politik LDK, ka përdorur fëmijë në tubimin e tij politik gjatë fushatës zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, paneli vlerësoi se kjo gjobë e shqiptuar do të ndikojë që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 134/2017 më datën 10.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Zyhdi Haxiri

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***